

Në bazë të nenit 93 paragrafi (6) i Ligjit të Energjetikës\* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2020, solli

## **A K T V E N D I M**

### **për miratimin e kërkesës për ndryshimin e kategorisë së kycjes**

1. Miratohet kërkesa e SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup nr. 12-1843/1 datë 9 shtator 2020 për ndryshimin e kategorisë së kycjes të konsumatorit Shoqëria e Tregtisë dhe Shërbimeve CRC - REGJISTRIM I VETURAVE SHPKNJP Shkup, me numër tatimor 4044015510813 edhe atë:
  - vendi i shpenzimit nr.104056000007,
  - adresa e vendit matës: Novo Selo,
  - kategoria ekzistuese e kycjes: LV2;
  - kategoria e re e kycjes: LV1.2;
  - niveli i tensionit të matjes: tension i ulët dhe
  - lokacioni i matjes: tension i ulët dhe dalje e veçantë deri te TS.
2. Obligohet SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup ta përditësojë listën nga neni 93 paragrafi (3) pika 5 të Ligjit të Energjetikës\* për ndryshimin e kategorisë së kycjes nga LV2 në LV1.2 të konsumatorit Shoqëria e Tregtisë dhe Shërbimeve CRC-REGJISTRIMI I VETURAVE SHPKNJP Shkup dhe posaçërisht ta theksojë arsyen për ndryshimin e kategorisë së kycjes.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

## **A r s y e t i m**

SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup, në bazë të nenit 93 paragrafi (6) të Ligjit të Energjetikës\*, ka dërguar deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kërkesë për miratim të ndryshimit të kategorisë së kycjes nr. 12-1843/1 datë 09 shtator 2020.

Kërkesa i referohet ndryshimit të kategorisë së kycjes nga LV2 në LV1.2 të konsumatorit Shoqëria e Tregtisë dhe Shërbimeve CRC - REGJISTRIMI I VETURAVE SHPKNJP Shkup, vendi i shpenzimit nr. 104056000007 dhe adresa e vendit matës: Novoselski pat, Skopje.

Kërkesa është dorëzuar si rezultat i dislokimit të planifikuar nga SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup, si operator i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, me të cilën vendi matës do të zhvendoset nga ndërtesa e shfrytëzuesit në dalje të veçantë të destinuar vetëm për shfrytëzuesin deri te TS. Me këtë është e nevojshme të ndryshohet kategoria e kycjes për këtë vend matës nga LV2 në LV1.2. Në shtojcë të kërkesës, SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup ka dërguar fotografi nga vendi matës, SGJI skicë dhe informatë se vendi matës nuk është në procedurë të ndërrimit të furnizuesit.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën si dhe nenin 4 paragrafi (2) pika 4 të Sistemit Tarifor të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për Konsumatorët e Kyçur në Sistemin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 95/19), në përputhje me të cilin në kategorinë LV1.2 bëjnë pjesë kycje me tension të ulët, përmes të cilave energjia elektrike mirret direkt nga mbledhës me tension të ulët në trafostacionet e tensionit të mesëm/ tensionit të ulët, gjatë së cilës matja e energjisë elektrike të dorëzuar mund të bëhet edhe në ndërtesën e konsumatorit nëse në dalje nuk është kyçur edhe ndonjë

konsumator tjetër, ndërsa energjia elektrike e marrë nuk është e destinuar për ndriçim publik, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ngritet kontest andministrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes.

**PA1, nr. 12-1843/2**

**14 shtator 2020  
Shkup**

**Kryetar i  
Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit  
të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

**Марко Бислимоски**